



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Nr. 1276/Prot

Tiranë, më 05.05/2021

Lënda: Njoftim për shpallje të lëvizjes paralele

SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE _____

DREJTORISË RAJONALE TË OFRIMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Urdhërit nr. 107, datë 13.08.2020 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” dhe shkresës nr.109 prot, datë 21.04.2021 “Njoftim për lëvizje paralele” të Shkollës së Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës, protokolluar në AKPA me nr.1276 prot, datë 26.04.2021,

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ju njofton shpalljen e procedurave të **lëvizjes paralele** për personelin mësimdhënës të formimit praktik, në Shkollën e Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës, për pozicionin:

- 1 mësimdhënës i formimit praktik në drejtimin TIK (vetëm për periudhën kohore të lejes së barrë lindjes së Znj. Marinela Suçi)

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të formimit praktik në Shkollën e Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;

f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të formimit praktik në Shkollën e Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës, si vijon:

- a) të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose të nivelit *bachelor* në një nga profilet, që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë të ketë paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2.Vendi dhe afati i dorëzimit të dokumentave

Aplikantët duhet të dorëzojnë kërkesën për lëvizje paralele dhe dokumentacionin përkatës pranë Shkollës së Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës, brenda 5 ditëve nga njoftimi. Afati i njoftimit fillon më datë 07.05.2021.

Nëse nuk paraqiten kërkesa për lëvizje paralele brenda afatit të mësipërm, Shkolla e Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës, të fillojë procedurën për shpalljen e vendit të lirë, për pozicionin:

- 1 mësimdhënës i formimit praktik në drejtimin TIK (vetëm për periudhën kohore të lejes së barrë lindjes së Znj.Marinelas Suçi)
- në zbatim të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”.

Shkolla e Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës brenda 5 ditëve pune pasi është mbyllur procedura e lëvizjes paralele dhe nuk është paraqitur asnjë kërkesë për lëvizje paralele, shpall njoftimin për vendin e lirë në faqen zyrtare të AKPA-s, në faqen elektronike zyrtare të Shkollës së Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të Shkollës së Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

